



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

№ 21866 Prot

Tiranë, më 27.9.2017

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

- **Specialist** në Sektorin e Investimeve dhe Logjistikës, në **Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse**, Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vend)

**Përshkrim përgjithësues për pozicionin:**

- Zbaton aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e sektorit dhe Drejtorisë së Investimeve dhe Logjistikës, udhëzimet e drejtuesve eprorëve, të dhëna në zbatim të tyre.
- Plotëson detyrat e përcaktuara për të nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Drejtori i Drejtorisë, në funksion të realizimit të planeve të punës.
- Transmeton tek eprori i drejtpërdrejtë të gjitha problemet, pyetjet lidhur me praktika të ndryshme për zbatim dhe administron me korrektesë praktikatat e ngarkuara për trajtim, duke mbajtur në vëmendje afatet e përpunimit.
- Studion nevojat për investime në degët doganore, duke harmonizuar kërkesat me investimet prioritare në përputhje me strategjitë e zhvillimit doganor.
- Merr pjesë në komisione të ngritura me qëllim përmirësimin e infrastrukturës së degëve doganore.
- Të administrojë me korrektesë praktikatat e ngarkuara për trajtim, duke mbajtur në vëmendje afatet e përpunimit.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere.

**Kriteret minimale:**

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

**Kriteret e veçanta:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, shoqërore, politike etj.
- Të ketë mbi 2 vjet eksperiencë pune në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 06.10.2017 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e të ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

**DREJTOR I PËRCJITSHËM**

**Belinda Ikonomj**

